

## I. Përse po verifikohem?

Në kuadër të procesit të formalizimit të ekonomisë shqiptare, administrata fiskale kontrollon nëse aktiviteti ekonomik ushtrohet korrekt, sipas ligjeve, nga subjekte të regjistruara. **Ajo kontrollon në vend bizneset për të evidentuar nëse janë deklaruar dhe paguar saktë tatimet dhe taksat.**

Kontrollet janë një mundësi edhe për biznesin, për të përmirësuar raportimin e saktë për efekt fiskal.

## II. Kur dhe ku do të kryhet? verifikimi?

Një grup kontrolli i përbërë nga inspektorë tatimorë do të paraqitet pranë pikës ku ju ushtroni aktivitetin dhe do të kontaktojë me ju për t'u njohur me pikat e verifikimit/kontrollit të programuar.

Verifikimi/Kontrolli mund të kryhet në:

- Biznesin tuaj
- Në adresat sekondare të biznesit tuaj
- Një nga zyrat e administratës lokale fiskale
- Zyrat e studios kontabile, të avokatit apo të përfaqësuesit të kompanisë

Ne jemi të angazhuar të punojmë me ju në mënyrë profesionale dhe bashkëpunuese.

Kontrollit mund t'i referohet momentit aktual, por me raste specifike mund të shtrihet nga fillimi i vitit kalendarik aktual, deri në momentin e ushtrimit të kontrollit, ose edhe për më shumë vite.

## III. Mënyra e trajtimit të disa prej tipologjive të riskut

D.P.Tatimeve, në sistemin e saj informatik ka të evidentuar deklaratat që subjektet pasqyrojnë sa i përket aktivitetit që ata kryejnë. Në koordinim edhe me D.P.Doganave, në kohë reale merret informacion lidhur me transaksionet e kryera dhe saktësinë e pasqyrimin të tyre në tatime dhe dogana.

Në këtë kuadër i jepet prioritet trajtimit të disa risqeve potenciale, të cilat mund të shërbejnë si indicje që mund të çojnë për verifikim dhe/ose kontroll si:

### A. Riksu i regjistrimit:

- DPT verifikon nëse transaksione e kryera janë realizuar nga subjekte aktive, dhe jo nga raste të tjera:

Rastet e abuzimit me X	Aktiv		Pasiv	
	blerës	shitës	blerës	shitës
Aktiv	blerës	- OK	-	X
	shitës	OK -	X	-
Pasiv	blerës	- X	-	X
	shitës	X -	X	-

- Administrata identifikon rastet kur një biznes mbyll Nipt-in dhe rihapën një të ri, në të njëjtën adresë, për të njëjtin aktivitet, në emër të një personi tjetër, me qëllim abuzimin me taksën 0.

### B. Riksu i raportimit:

- DPT kryqëzon kryesisht të dhënat që merren nga deklarimi i librave, me ato të doganave, si dhe informacionet nga institucione të ndryshme, etj. me deklaratimet që pasqyron tatimpaguesi, dhe evidenton nëse ka raste jo të pasqyruara korrekt, kryesisht për:
  - Deklaratën e TVSH
  - Deklaratën e Tatimit mbi Fitimin
  - Deklaratën për Tat. e Thjeshtuar Fit.
  - Deklaratën e Tatimit në Burim
  - Deklaratën/Listëpagesa për Kontributet Shoqërore dhe Shëndetësore, TAP
  - Deklarata Individuale Vjetore për të Ardhurat Personale.
- Gjithashtu i referohet edhe rastit të:
  - Kryerjes së shitjeve pa lëshuar fatura, pa patur kasë fiskale, ose duke patur kasë dhe mos lëshuar kupon tatimor, për efekt fshehje qarkullimi.

### C. Risku i nëndeklarimit për:

- Nënndeklarim i çmimeve dhe/ose i xhiros

Kur subjektet faturtojnë mallrat dhe shërbimet me çmime më të ulëta se ato reale, dhe me vlerë të ndryshme nga ajo çka në të vërtetë arkëtojnë.

### ➤ Nënndeklarim i blerjeve

Prirja e fshehjes dhe mospasqyrimin të blerjeve me qëllim justifikimin dhe fshehjen e shitjeve.

### D. Risku i kreditimit:


- Tepricë kreditore afatgjatë e pajustificuar

Kur subjektet nuk arrijnë të justifikojnë ligjërisht gjendjen e mbartur kreditore.

## IV. Bllokskema e trajtimit të tipologjive të riskut

Në kuadër të konsolidimit, sigurimit të konkurrencës së ndershme, shmangies së abuzimeve me taksën 0, në partneritet me subjektin, administrata mund të kryejë:

- **Saktësim të situatës fiskale dhe/ose ndryshim të përgjegjësisë tatimore:**



## IV.i Verifikim i menjëhershëm:

Një kontroll i aktiviteteve të biznesit tuaj mund të përfshijë disa aspekte kryesore, të çastit, të tilla si:

1. Regjistrimi në organet tatimore
2. Deklarimi i të punësuarve në sistemin tatimor, (sipas ligjit - të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës)
3. Instalimi dhe përdorimi i pajisjes fiskale (disponimi i dëftësave tatimore)
4. Deklarimi i çmimeve, afishimi i tyre në vende të dukshme për klientin
5. Afishimi në vend të dukshëm për klientin i posterit për tërheqjen e kuponit tatimor
6. Akti i pronësisë ose kontrata e qirasë për ambientin ku ushtrohet aktiviteti

## IV.ii Monitorimi i xhiros

Një alternativë tjetër e administratës fiskale është të kryejë edhe:

- **Monitorim xhiro ditore të aktivitetit tregtar**
- **Vlerësim i kostove të aktivitetit**

Xhiroja e shitjeve monitorohet nga grupi i kontrollit në ditë dhe orare të ndryshme, si dhe duke marrë në konsideratë edhe kostot e funksionimit.

- Mbi bazën e të cilave do përcaktohet/saktësohet edhe ndryshimi ose jo i përgjegjësisë tatimore.

## IV.iii Inventari

Krahas pikave të përmendura, në mënyrë specifike, kontrollet mund të ushtrohen edhe për inventarët e mallrave që disponon subjekti, ku përfshihen disa aspekte kryesore, si:

- **Kryerja e inventarit fizik në momentin e kontrollit**
- **Tërheqja e inventarit kontabël të fillimit të vitit dhe/ose të ditës së kryerjes së inventarit fizik.**

→ **Kryerja e lëvizjes materiale nga fillimi i vitit deri në ditën e përfundimit të inventarit fizik**

- Kryerja e inventarit fizik të arkës  
→ Evidentimi i lëvizjeve me arkë, nga fillimi i vitit deri në ditën e inventarit fizik të arkës.

#### IV.iv Kontroll i thelluar

Në rastet kur transaksionet e regjistruara, deklaratat, dokumentacioni i ofruar nga tatimpaguesi, apo pretendimet e tij, nuk janë bindëse për administratën tatimore, sa i përket vërtetësisë dhe saktësisë së tyre, mund të të kalohet në një kontroll të thelluar.

Periodha e kontrollit zakonisht i referohet pesë viteve ushtrimore/kalendarike paraardhëse, si dhe periudhës nga fillimi i vitit kalendarik aktual, deri në momentin e ushtrimit të kontrollit.

- ✦ Një inspektor i kontrollit do të kontaktojë me ju për të programuar një takim.  
Do të ketë mirëkuptim (sipas ligjit) sa i takon caktimit të datës dhe orës.

Një kontroll i aktiviteteve të biznesit tuaj mund të përfshijë disa fusha kryesore, të tilla si:

1. **Të ardhurat** - verifikim i saktësisë së shumave të raportuara, si janë klasifikuar dhe dokumentuar, deklaruar, etj.
2. **Blerjet** – verifikim i saktësisë së shumave të raportuara, si janë klasifikuar, sa justifikues janë dokumentat e tatimpaguesit në përputhje me udhëzimet e Ministrit të Financave, në zbatim të legjislacionit tatimor, si dhe në përputhje me aktivitetin.
3. **Kontributet** - verifikim i punonjësve të siguruar, saktësisë së deklarimit të pagave, shumave të raportuara, llogaritjes dhe derdhjes në kohë të kontributeve, etj.

#### V. Si mund të përgatitemi për verifikimin/kontroll?

Inspektori do t'ju përshkruajë pikat e programit të punës. Normalisht ju duhet të siguroheni për:

- ✓ Afishimin e Niptit në adresën kryesore dhe Niptet sekondare në adresat respektive.
- ✓ Pasjen e një listëpagese apo edhe të E-sig 27 për punonjësit e deklaruar rishtazi.
- ✓ Kontratat e punës, listëprezencat e firmosura për punonjësit. (Sigurimin që çdo punonjës të ketë një kartë identiteti me qëllim verifikimin saktë të tij).
- ✓ Funksionim i kasës fiskale sipas parametrave ligjorë. Të hapet para fillimit të punës, si dhe të kryhet mbyllja për transmetimin ditor në përfundim të punës (ose turnit respektiv).
- ✓ Disponimin e mandat-arkëtimeve dhe mandat-pagesave, ditarit/librit të arkës.
- ✓ Disponimin e transaksioneve të dokumentuara me banka (brenda dhe jashtë vendit).
- ✓ Disponimin e kontratës së qirasë apo aktit të pronësisë ku ushtrohet aktiviteti.
- ✓ Bilancet kontabile sipas periudhave respektive
- ✓ Disponimin e inventarit të fillim vitit, në sasi, vlerë dhe kosto blerje, sipas mallit.
- ✓ Disponimit të faturave justifikuese të blerjeve në funksion të aktivitetit, sipas furnitorëve respektivë (kontratat, situacionet aty ku ka)
- ✓ Skeduli i amortizimit dhe faturat e blerjes për aktivet e periudhës së kontrollit.
- ✓ Disponimit të faturave të shitjeve (xhirot e kasës/dëftësat tatimore), sipas klientëve respektivë (kontratat, situacionet, nëse ka)
- ✓ Dokumentat justifikues për çdo zbritje apo përjashtim në blerje dhe/ose shitje.
- ✓ Kontratat për shërbimet e kryera apo të përfutuara, evidenca për tatimn në burim.

Regjistrimet, deklaratimet që do kontrollohen (libri i blerjeve/ libri i shitjeve, arkëtimet/ pagesat) duhet t'i azhroni ditë pas dite, në koherencë me ushtrimin e aktivitetit.

📁 Megjithëse pjesa kryesore e kontrollit konsiston në dokumentat e sipërcituar, gjatë këtij procesi mund të kërkojnë dokumenta shtesë.

#### Regjistrimet elektronike

Për reduktimin e kohës së kryerjes së kontrollit, ku është e mundur mund të ofrohen të dhënat elektronikisht në CD, ose nëpërmjet e-mail, etj.

#### Kontrolli me përzgjedhje/ kampionët

Kontrolli me përzgjedhje (aty ku është e mundur) është përdorur shpesh për të patur efikasitet, si për administratën dhe për tatimpaguesin. Kjo metodë përdoret veçanërisht në inventarët me peshë më të madhe, apo në caktimin e orareve të ndryshme gjatë ditëve të ndryshme, për monitorim.

Inspektorët do të trajtojnë rastet me ju, si dhe do zgjidhen alternativat më të përshtatshme.

#### Konfidencialiteti

I gjithë informacioni që ju ofroni do të mbahet në mirëbesim dhe nuk do të jetë i vlefshëm për publikun. Sifoqoftë, duhet të jeni të vetëdijshëm se administrata tatimore ka marrëveshje edhe me institucione të tjera shtetërore për shkëmbimin e informacionit.

#### VI. Çfarë ndodh gjatë një verifikimi/kontrolli?

Grupi i kontrollit mund të kryejë një tur inspektimi për vëzhgimin e proceseve të operimit të biznesit. Kjo ndihmon në kuptimin më mirë të aktivitetit që ushtrohet. Inspektori do t'ju ofrojë informacion të vlefshëm për përdorim të mëtejshëm në punë.

#### VII. A Çfarë ndodh më pas? Verifikim i menjëhershëm, monitorim xhiro. inventarë

1. Në rastin e inspektimit të zakonshëm, inspektorët do t'ju shpjegojnë për mangësitë/zbulimet që ka evidentuar grupi i kontrollit. Mbahet në vend Akt-Konstatimin ku përshkruhet zbatimi i pikave të Urdhërit të Punës, si dhe faktet e evidentuara.

Ai mund të shoqërohet me mbajtjen e Proçesverbalit të Gjobës, për rastet e konstatuara me mangësi ligjore.

2. Në rastin e saktësisimit të përgjegjësive tatimore, monitorimit të xhiros, në përfundim të çdo dite kontrolli, mbahet Akti i Konstatimit.

Në përfundim të procesit të monitorimit, (kjo edhe në varësi të pikave të programit) grupi i kontrollit bën me dije ndryshimin potencial ose jo të përgjegjësive tatimore sipas legjislacionit, për të cilat përpilohet dhe një raport verifikimi, në zbatim të pikave të programit.

3. Në rastin e inventarëve, në përfundim të çdo dite, inspektorët mbajnë Aktin e Konstatimit ku evidentohen zërat dhe sasitë e inventarizuara, si dhe në përfundim të procesit mbahet një proçesverbal përmbledhës për punën e kryer. Përpilohet raporti i verifikimit dhe nëse nga kontrolli rezultojnë mangësi, bashkëlidhet Njoftim Vlerësimi me detyrimet respektive.

Vetëm pasi miratohet nga Drejtoria Rajonale, materiali vjen me e-mail, sistem, postë edhe për tatimpaguesin.

*Nëse ju keni të dhëna të cilat nuk i kemi trajtuar, apo nëse besoni se kemi bërë gabime, ju lutemi menjëherë bëjuani me dije inspektorëve që kanë kryer kontrollin.*

#### Nëse ju jeni dakord me zbulimet/ndryshimet:

Ju mund të deklaroni se jeni dakord me rezultatet e kontrollit dhe nuk do bëni apelim.

Nëse keni paguar më tepër se detyrimi, ju do të mund ta përdorni për mbulimin e detyrimeve të tjera në të ardhmen apo të kërkonti rimbursim sipas rastit.

#### Nëse ju nuk jeni dakord me vlerësimin:

Ju mund të kërkonti një takim ballafaques me përgjegjësën e kontrollit, si dhe të rishqyrtoni pretendimet për çështjet që ngrini.

Nëse takimi nuk është produktiv **ju keni 30 ditë kohë nga data e kalimit të raportit së bashku me njoftim vlerësimin, me e-mail, sistem, postë, për ta apeluar në Drejtorinë e Apelit, në DPT.**

Nëse ju paraqitni një kërkesë të tillë duhe të paguani detyrimin për pjesën e paapeluar ose të vendosni garancitë bankare sipas ligjit. PAGESA nuk kërkohet për detyrimin që apleohet dhe do të mbetet pezull për sa kohë që shqyrtohet në apel.

## VII. B Çfarë ndodh më pas?

### Kontrolli i thelluar

Praktika nga fillimi i kontrollit deri në përfundimin e fazës së dytë mund të variojë 4-8 javë kohë.

Ju do të njoftoheni për mangësitë, dhe inspektori do t'u shpjegojë ju ose përfaqësuesit tuaj çdo sistemim para se ta përfundojë kontrollin. *Nëse keni të dhëna të ciat ne nuk i kemi trajtuar, apo nëse besoni se kemi bërë gabime, ju lutemi kontaktoni me inspektorin.*

#### Nëse ju jeni dakord me zbulimet/sistemimet:

Ju mund të deklaroni se jeni dakord me rezultatet e kontrollit paraprak dhe nuk do bëni observacion. Në këtë mënyrë do hartohet kontrolli përfundimtar. Në këtë të fundit, bazuar në “Njoftim vlerësimit” mund të bëni pagesën e detyrimeve dhe penaliteteve. Ju do të kurseni 25 ditë kohë nga data e kontrollit paraprak deri në hartimin e atij përfundimtar.

Nëse keni paguar më tepër se detyrimi, ju mund ta përdorni për mbulimin e detyrimeve të tjera në të ardhmen. ose të kërkonim rimbursimin, sipas rastit.

#### Nëse ju nuk jeni dakord me vlerësimin:

*Ju mund të kërkonim një takim ballafaques me përgjegjësën e kontrollit gjatë kryerjes së kontrollit apo edhe në periudhën 25 ditore para hartimit përfundimtar, si dhe të rishqyrtoni pretendimet për çështjet që ngrini.*

Nëse takimi nuk është produktiv mund të bëni observacion brenda 25 ditëve nga përfundimi i raportit paraprak të kontrollit tatimor.

Nëse obsevacioni nuk merret në konsideratë pjesërisht apo tërësisht, ju keni 30 ditë kohë nga data e kalimit të raportit përfundimtar së bashku me njoftim vlerësimin, me e-mail, sistem, postë, për ta apeluar në DPT.

Nëse ju paraqitni një kërkesë të tillë duhet të paguani detyrimin për pjesën e paapeluar ose të vendosni garancitë bankare sipas ligjit. Pagesa nuk kërkohet për detyrimin që apelohe dhe do të mbetet pezull për sa kohë që shqyrtohet në apel.

Tatimpaguesi mund ta kundërshtojë vendimin e drejtorisë së apelimit tatimor në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim. **Nëse drejtoria e apelimit tatimor nuk shprehet brenda 60 ditëve nga data e marrjes së ankimit, tatimpaguesi mund të ankohet drejtpërdrejt në gjykatë**

### Proçesi i kontrollit të thelluar



## CILAT JANË TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E TATIMPAGUESIT?

### Të drejtat e tua si tatimpagues i Shtetit Shqiptar, midis të tjerave përfshijnë:

- Trajtim në kohën e duhur, i drejtë, i barabartë, me dinjitet dhe respekt
- Proçes të thjeshtë dhe të shpejtë sa i përket rimbursimit fiskal
- Takime publike për rregullat e propozuara
- Informacion i shkruar saktë për udhëzimet në lidhje me, procedurat e apelimit, kërkesat për rimbursim, dhe arsyet për vlerësim
- Shqyrtim i ankesave, i çështjeve që kalojnë në apel, rregullat e çregjistrimit, etj.
- Ruajte e konfidencialitetit të të dhënave tatimore dhe financiare, që sigurohen gjatë kryerjes së detyrës nga inspektori.
- Rishikim, aty kur ligjet dhe rregullat vlerësohen të jenë antikushetuese

### Përgjegjësitë e tua si tatimpagues përfshijnë:

- Regjistrim dhe deklarimi i saktë dhe koherent i të ardhurave dhe shpenzimeve, transaksioneve
- Të njohësh detyrimet e tua fiskale dhe të kërlesh udhëzime kur jeni i pasigurtë
- Plotësim, dërgim në kohë i deklaratave dhe pagesa të rregullta
- Sigurohu për saktësinë e informacionit të përfshirë në deklaratë
- Informacion i saktë për pretendimin për rimbursim
- Njoftim në kohë i administratës në rastet kur doni të mbyllni aktivitetin

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
Adresa: Rr. “Gjin Bue Shpata”, pranë Stadiumit “Dinamo”,  
Tiranë Web site: [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al), Tel: ++ 355 42276840

Përgatitur nga Drejtoria e Riskut, DPT

## Verifikim i pajtueshmërisë vullnetare

- Çfarë pritet?
- Si të përgatitemi?
- Cilat janë të drejtat e tatimpaguesit?



Për më shumë të dhëna rreth këtij proçesi, ju lutemi kontaktoni drejtorinë tuaj rajonale

